



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E DREJTËSISË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E KODIFIKIMIT DHE HARMONIZIMIT TË
LEGJISLACIONIT

Nr. 2848/prot.
6

Tiranë, më 31/10/2025

Lënda: Mbi përcjelljen e urdhrit nr. 631, datë 29.10.2025, të Ministrit të Drejtësisë

DREJTORISË SË NDIHMËS JURIDIKE FALAS

Tiranë

Në vijim të miratimit nga Ministri i Drejtësisë të urdhrit nr. 631, datë 29.10.2025 “Për disa ndryshime në urdhrin nr. 225, datë 25.03.2019, të Ministrit të Drejtësisë, ‘Për miratimin e formularëve të ndihmës juridike të garantuar nga shteti’”, bashkëlidhur ju përcjellim urdhrin për njohje dhe zbatim.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin,

ZËVENDËSMINISTËR

Elona Hoxha





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
MINISTRI

Nr. 2848/prot.
6

Tiranë, më 29 . 10 .2025

URDHËR

Nr. 631, Datë 29 . 10 .2025

“PËR DISA NDRYSHIME NË URDHRIN NR. 225, DATË 25.03.2019 TË MINISTRIT TË DREJTËSISË ‘PËR MIRATIMIN E FORMULARËVE TË NDIHMËS JURIDIKE TË GARANTUAR NGA SHTETI’”

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 7 të ligjit nr. 8678, datë 14.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar dhe të shkronjës “d”, të nenit 7, 17 dhe 19 të ligjit nr 111, datë 14.12.2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”,

URDHËROJ:

I. Në urdhrin nr. 225, datë 25.03.2019 të Ministrit të Drejtësisë “Për miratimin e formularëve të ndihmës juridike të garantuar nga shteti”, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Në shtojcën I, në rubrikën 5, pika C, bëhet ndryshimi si më poshtë:

“Dokumente të tjera:

- a) *çertifikatë familjare;*
- b) *vërtetim mbi disponimin ose jo të pasurive të paluajtshme, si dhe*
- c) *dokumentet e mëposhtme sipas rastit:*
 - i. *vërtetim papunësie;*
 - ii. *vërtetim për trajtim me ndihmë ekonomike;*
 - iii. *vërtetim për trajtim me KEMP;*
 - iv. *vërtetim page bruto dhe neto;*
 - v. *vërtetim nga sigurimet shoqërore në rast të pagesës që kryhet prej këtyre institucioneve.”*

2. Në shtojcat II dhe III, në rubrikën 5 të tyre, pika D, ndryshohet si më poshtë:

“Dokumente të tjera:

- a) *çertifikatë familjare;*
- b) *vërtetim mbi disponimin ose jo të pasurive të paluajtshme, si dhe*
- c) *dokumentet e mëposhtme sipas rastit:*
 - i. *vërtetim papunësie;*

- ii. vërtetim për trajtim me ndihmë ekonomike;
- iii. vërtetim për trajtim me KEMP;
- iv. vërtetim page bruto dhe neto;
- v. vërtetim nga sigurimet shoqërore në rast të pagesës që kryhet prej këtyre institucioneve.”

3. Ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Drejtësisë dhe Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.

4. Ngarkohet sektori i Arkiv-Protokollit për njoftimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I DREJTËSISË

Besfort Lamallari

